



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	23.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-3717/15
PËR/ZA/TO:	z. Betim Jahaj – Zyrtar Ligjor/ MKRS
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Jahaj,

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK 03-02/3717/15), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (LPKI), Agjencia bënë “*këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave*” (Neni 19, pika 1.5 e Ligjit nr. 04/L-051)

Kërkesa juaj ka të bëjë me sqarimin nga Agjencia kundër Korrupsionit, lidhur me situatën se a ka konflikt interesi në rastin e vlerësimit të projekteve filmike në Qendrën Kinematografike të Kosovës, për arsye se disa aplikues të këtij konkursi, janë ankuar për vendimin për përbërjen e jurisë vlerësuese me pretendimin se njëri nga anëtarët e jurisë (Xhergj Xhuvani) ka konflikt interesi me këta aplikantë.

Nga informacionet e dërguara nga ju dhe në takimin që kemi pasur në Ministri, shihet se konkursi për projekte filmike tashmë ka përfunduar dhe tani është vonë të flasim për parandalim të konfliktit të interesit sepse procesi ka rrjedhur dhe është vendosë fituesi. Prandaj, pyetja është dashur të parashtrohet në fazën e emërimit të komisionit vlerësues për përzgjedhjen e projekteve filmike.

Po ashtu, z. Xhuvani në cilësinë e anëtarit të komisionit vlerësues për projekte filmike nuk është zyrtar i lartë publik dhe nuk i nënshtrohet dispozitave të Ligjit PKI (neni 4).

Pavarësisht kësaj, Këshilli Drejtues i Qendrës Kinematografike, bazuar në legjislacionin e brendshëm të Qendrës Kinematografike dhe kufizimeve të cilat i përcakton ky legjislacion, është dashur të ketë parasysh raportet e kompanive “Land Film”, “Dat Film”, “AS Film”, “Ballkan Film”, “Da’ Art Picture” dhe “Plisi Film”, me anëtarët zgjedhur të Jurisë Vlerësuese të projekteve filmike.

Me respekt!

OF KOSOVO